

SYLLABUS – Të nxënit përmes eksperimenteve

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit Master i mësimdhënies lëndore me specializim në KIMI
Titulli i lëndës:	Të nxënit përmes eksperimenteve
Niveli I studimeve:	MASTER
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i dytë, Semestri i tretë
Numri i orëve në javë:	3+0 (3 orë)
Vlera në kredi – ECTS:	5 ECTS
Koha / lokacioni:	E martë 14:30 – 16:45 Laboratori i kimisë 305
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Asoc. Dr.Arlinda Bytyqi - Damoni
Detajet kontaktuese:	arlinda.damoni@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Ky kurs ka për qëllim të pajisë mësimdhënësit e ardhshëm me një makro eksperiencë në transmetimin e eksperimenteve laboratorike, demonstrimin e tyre, dhe përdorimin e strategjive të mësimdhënies përmes eksperimentit. Kursi ofron një qasje interaktive të eksperimenteve me përmbajtje tematike të ndryshme nga lënda e kimisë (kimi të përgjithshme, inorganike, analitike dhe fizike). Eksperimentet do të sfidojnë dhe motivojnë studentët duke ju dhënë një mundësi të drejtpërdrejtë për të fituar aftësi/shkathtësi shkencore të mësimdhënies të cilat duhet t'i transmetojnë si mësimdhënës të ardhshëm dhe të bëjnë ndërlidhjen me jetën reale. Pjesëmarrja në eksperimente promovon të mësuarit aktiv, duke i inkurajuar studentët të pyesin, të eksplorojnë dhe për të vendosur një lidhje midis nocioneve teorike dhe zbatimeve praktike. Të nxënit përmes eksperimentit për konceptet dhe teoritë komplekse, për më tepër përgatit ata për karriera të mundshme që kërkojnë aftësi thelbësore praktike.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Kursi ka për qëllim që të angazhojë studentet në seanca eksploruese (duart në qasje shkencore), interpretimin publik të demonstrimeve eksperimentale në të ardhmen, dhe integrimin e shkencës së kimisë me diciplinat tjera.</p>

Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ demonstrojnë shkathtësi për zgjidhjen e problemeve në laborator dhe në jetën e përditshme; ▪ demonstrojnë qasje dhe vlera shkencore, analitike dhe të të menduarit kritik; ▪ transferojnë njohuritë dhe shkathtësitë laboratorike të fituara tek shoqëria dhe mjedisi. ▪ bëjnë pyetje shkencore drejt ngritjes së hipotezës, të parashikoj dhe më në fund të mund të jap përgjigje. ▪ vlerësojnë vlerën e shkencës dhe teknologjisë si dhe rëndësinë e tyre në jetën e përditshme; ▪ mësojnë të promovojë dhe motivojë shkencën nëpërmjet eksperimenteve dëfruese /argëtuese;
---	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	2	11	22
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	2	2
Projektet,prezentimet ,etj	3	2	6
Totali			125 orë
123: 25 ≈ 5 ECTS.			
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, puna në grupe, punë në çifte, punë me projekte laboratorike.		

--	--

<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<p>Vlerësimi mbështetet në këto aktivitete:</p> <p>20 % Demonstrim i eksperimentit personal 1 (Planifikimi i eksperimentit sipas modelit 5E)</p> <p>20 % Demonstrim e eksperimentit personal 2 (Planifikimi i eksperimentit sipas modelit ADI)</p> <p>20 % Detyrat javore</p> <p>10 % Projekt hulumtues</p> <p>30% Vlerësimi perfundimtarë</p> <table data-bbox="1006 583 1234 793"> <thead> <tr> <th colspan="2"><u>Pikët (%)</u></th> <th><u>Nota</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>94 - 100</td> <td></td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>84 - 93</td> <td></td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>73 - 83</td> <td></td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>61 - 72</td> <td></td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>50 - 60</td> <td></td> <td>6</td> </tr> </tbody> </table>	<u>Pikët (%)</u>		<u>Nota</u>	94 - 100		10	84 - 93		9	73 - 83		8	61 - 72		7	50 - 60		6
<u>Pikët (%)</u>		<u>Nota</u>																	
94 - 100		10																	
84 - 93		9																	
73 - 83		8																	
61 - 72		7																	
50 - 60		6																	
<p>Literatura</p>																			
<p>Literatura bazë:</p>	<p>1. Thompson, R. B. (2008). Illustrated Guide to Home Chemistry Experiments: All Lab, No Lecture (1st ed.). O'Reilly Media</p> <p>2. Shakhashiri, B. (2011). Chemical Demonstration: A handbook for Teachers of Chemistry, Volume 5 (1st ed.). University of Wisconsin Press.</p> <p>3. Shakhashiri, B. Chemical Demonstrations: A handbook for teachers fo Chemistry, Volume 1, 2, 3, 4. University of Wisconsin Press.</p>																		

<p>Literatura shtesë:</p>	<p>Nazli, A. (2002). Chemistry Laboratory Experiments</p>
----------------------------------	---

Plani i dizajnuar i mësimit:		
Java	Ligjerata që do të zhvillohet	
Java e parë:	Paraqitja e kursit. Syllabusi dhe detyrat	17 Shtator 2024
Java e dytë:	Roli i eksperimentit në mësimdhënien dhe mësimnxënien e kimisë (shqyrtim i hulumtimeve të fundit)	24 Shtator 2024
Java e tretë:	Eksperimenti i bazuar në kërkim (dallimet me atë tradicionale)	1 Tetor 2024
Java e katërt:	Eksperimenti i bazuar në kërkim sipas (modelet 5E, 7E, ADI)	8 Tetor 2024
Java e pestë:	Hartimi i storieve dhe ngritja e hipotezës bazuar në storie	15 Tetor 2024
Java e gjashtë:	Vlerësimi i arritjeve të studentëve përmes eksperimentit (paratesti dhe postesti)	22 Tetor 2024
Java e shtatë:	Prezentim i eksperimentit personal të planifikuar sipas qasjes kerkuese (5E)	29 Tetor 2024
Java e tetë:	Prezentim i eksperimentit personal të planifikuar sipas qasjes kerkuese (5E)	5 Nëntor 2024
Java e nëntë:	Eksperimenti i bazuar në argument (fazat e hatimit)	12 Nëntor 2024
Java e dhjetë:	Planifikimi i eksperimentit sipas qasjes ADI (shembull nga kimia inorganike)	19 Nëntor 2024
Java e njëmbëdhjetë:	Planifikimi i eksperimentit sipas qasjes ADI (shembull nga kimia analitike)	26 Nëntor 2024
Java e dymbëdhjetë:	Planifikimi i eksperimentit sipas qasjes ADI (shembull nga kimia organike)	3 Dhjetor 2024
Java e trembëdhjetë:	Prezentim i eksperimentit personal të planifikuar sipas ADI-se	10 Dhjetor 2024
Java e katërbëdhjetë:	Prezentim i eksperimentit personal të planifikuar sipas ADI-se	17 Dhjetor 2024
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi përfundimtarë	24 Dhjetor 2024

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes

- Studentët janë të obliguar të përcjellin ligjëratat dhe të kryejnë detyrat praktike. Nëse studenti mungon për tri javë, apo nuk i krzen obligimet të paraqitura në syllabus nuk i nënshtrohet vlerësimit përfundimtarë dhe detyrohet ta rindëgjoj lëndën në vitin pasues.
- Studenti është i obliguar ta bëj prezentimin në kohën e caktuar nga mësimdhënësi. Mungesa në ditën e prezentimit nuk mund të kompensohet
- Detyrat dorezohen deri në ora 00:00 te datës së caktuar nga mësimdhënësi. Detyrat e dorëzuara pas kësaj kohe nuk merren ne konsideratë.
- Studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe të marrin pjesë në çdo aktivitetet.
- Gjatë orëve mësimore dhe provimeve nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë.
- Fotografimi apo inçizimi pa leje në orë është i ndaluar me rregullore të UP. Nuk lejohet ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye.